



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP. Anr.54/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli - kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Ramush Bardiqi -anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet Parakohshme për Kuvend të Kosovës, të datës 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 30.12.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.54/2025, e datës 28.12.2025, parashtruar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, parashtruar kundër Subjektit Politik, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet Parakohshme për Kuvend të Kosovës,, të datës 28 Dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 28.12.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se më datë 28 Dhjetor 2025, në ditën e votimit, ora 09:09, në platformën Facebook është shfaqur një përmbajtje politike e sponsorizuar nga ana e kandidatit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Burim Ramadani, e identifikuar qartazi me shënimin "Sponsored". Kjo përmbajtje përmban mesazh politik dhe ideologjik, të dizajnuar për të ndikuar drejtpërdrejt në bindjen dhe vullnetin e votuesve, dhe është shpërndarë përmes mekanizmit të pagesës së platformës Meta, çka nënkupton shtrirje të qëllimshme dhe të kontrolluar të mesazhit tek publiku. Neni 8, paragrafi 1 i Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 përcakton se ndalimet e heshtjes zgjedhore zbatohen nga hapja e qendrave të votimit për votim dhe deri në mbylljen e tyreⁿ.

Më tej në ankesë theksohet se fakti që përmbajtja është e sponsorizuar e dallon qartazi këtë rast nga situatat e zakonshme të postimeve të publikuara më herët. Reklama e paguar përbën një veprim aktiv nga ana e subjektit politik, përmes mbajtjes aktive të buxhetit reklamues dhe mospezullimit të saj gjatë periudhës së ndaluar nga ligji, subjekti politik ka

pasur mundësi reale dhe kontroll të plotë për ta ndalur ose ç'aktivizuar reklamën para fillimit të heshtjes zgjedhore, por një veprim i tillë nuk është ndërmarrë.

Zhvillimi i një aktiviteti të tillë gjatë heshtjes zgjedhore dhe ditës së votimit përbën shkelje të drejtpërdrejtë të legjislacionit zgjedhor, vecanërisht të parimit të barazisë së garës. Në këtë rast, shkelja është e qartë e dokumentuar dhe e provueshme përmes provës vizuale të bashkëngjitur, nga e cila rezulton pa asnjë dyshim natyra politike e përmbajtjes, forma e saj e sponsorizuar dhe koha e shfaqjes së saj gjatë ditës së votimit.

Në këto rrethana, kërkojnë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa që ta pranojë këtë ankesë si të bazuar, të konstatojë se Subjekti Politik AAK, dhe kandidati i saj Burim Ramadani, ka zhvilluar fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin gjatë heshtjes zgjedhore, dhe të shqiptojë masën ndëshkuese përkatëse në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Si provë ka bashkëngjitur fotografi të postimit.

Në përgjigje në ankesë të Subjekti Politik AAK, thekson se nëpërmjet kësaj përgjigjeje ndaj ankesës, kundërshton në tërësi pretendimet e subjektit politik LVV, duke i konsideruar ato të pabazuara.

Fillimisht theksojnë se në fotografinë e bashkëngjitur ankesës nuk mund të bëhet evidente data apo ora se kur është shfaqur kjo përmbajtje në profilin e z. Burim Ramadani. Rrjedhimisht nuk ka asnjë provë se fotografia është shfaqur gjatë ditës së zgjedhjeve dhe se në këtë rast nuk ka të bëjë fare me shkelje të dispozitave që rregullojnë çështjen e heshtjes zgjedhore.

Më tej në përgjigje theksojnë se përmbajtja e shfaqur në profilin e cilitdo kandidat për deputet gjatë ditës së zgjedhjeve, nuk përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor vetëm për faktin se mbanë përshkrimin sponsored, por duhet të vlerësohet përmbajtja e materialit të shfaqur.

Nëse shohim me vëmendje fotografinë e bashkëngjitur ankesës, mbi bazën e të cilës fotografi LVV, pretendon se argumentohet shkelja e legjislacionit zgjedhor, shihet fare qartë se fotografia nuk përmban asnjë element sponsorizues, emblemë apo logo. Në fotografi shfaqet vetëm profili i z. Haradinaj, me përshkrimin "Siguria dhe mbrojtja janë mbi gjithçka tjetër!"

Sipas përgjigjes në ankesë as fotografia dhe as përshkrimi i fotografisë, nuk përmbajnë asnjë element që mund të asocioj në material zgjedhor, fushatë zgjedhore apo shkelje të dispozitave përkatëse që rregullojnë çështjen e heshtjes zgjedhore,

Andaj i propozojnë PZAP-it, që pas shqyrtimit të kësaj përgjigjeje në ankesë të sjell Vendim me të cilin e refuzon ankesën e parashtuar nga subjekti politik LVV të identifikuar sipas shenjes A.nr.54/25 si tërësisht të pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar

Parashtuesi i ankesës subjekti politik LVV në ankesën e tij ka theksuar se kandidati për anëtarë të Kuvendit të Kosovës, nga radhët e Subjektit Politik AAK, Burim Ramadani në rrjete sociale ka postuar/shfaqur një përmbajtje politike, mesazh politik dhe ideologjik, të dizajnuar për të ndikuar drejtpërdrejt në bindjen dhe vullnetin e votuesve, dhe është

shpërndarë përmes mekanizmit të pagesës së platformës Meta të sponsorizuar. Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë parashtuesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të nenit 37 par. 1 pika 2 i LZP-së, apo të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024.

Në rastin konkret nga provat e prezantuara nga ankuesi në provën e bashkangjitur si dëshmi nuk shihet ndokund data 28 Dhjetor 2025 për të cilën pretendohet si datë e publikimit të shfaqjes në rrjetin social Facebook të kandidatit Burim Ramadani, meqenëse nuk është dëshmuar nga ankuesi data e publikimit të shfaqjes. Paneli, konform nenit 13 par. 7 të Rregullores Nr. 01/2025, për Procedurat e Parashtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me të cilin parasheh *"Paneli para se të vendos lidhur me ankesën mund të kryej hetim nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme"*. Andaj Paneli ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se e njëjta është e pabazuar, pasi që nga hulumtimi dhe verifikimi në rrjetin social Facebook shihet se postimi në fjalë për të cilin pretendohet në ankesë nuk është bërë në ditën e votimit dhe e njëjta nuk është e sponsorizuar. Andaj bazuar në ato që u tha Paneli nuk ka gjetur shkelje të dispozitave të lartcekura të LZP-së apo të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024.

Paneli, vlerësoi se ankesa është e pabazuar, pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtuesi i ankesës i ka bashkangjitur në ankesë, nuk mund të vërtetohet se është kryer shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese, pasi që nga provat e administruara është vërtetuar se postimi është bërë gjatë fushatës zgjedhore, dhe se e njëjta nuk ka mundur të vërtetohet se i njëjta shfaqje është postuar apo është ri postuar në ditën e zgjedhjeve siç pretendohet në ankesë nga ana e subjektit ankues.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 par.3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 par. 1 të Ligjin Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.54/2025 më datën 30.12.2025

Kryesues i Panelit,
Kuqtim Pasuli

PZAP
LZP

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.